



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1019\_09\_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 27.09.2013.

**në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F.D., (shifra e konsumatorit DPR - 2004150) nga Fushë Kosova ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1019\_09\_13 i datës 09.09.2013.

**Arsyetim**

Departamenti i faturimit në KEK me datë 03.02.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin 01/2013 me shpenzim prej 3000 kWh apo llogaritur në vlerë financiare 294€, si dhe me datë 05.03.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin 02/2013 me shpenzim prej 2132 kWh në vlerë financiare 202.88€.

Pas arritjes së këtyre dy faturave të energjisë elektrike konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturat janar dhe shkurt 2013.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 27.03.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 4939399: TL=028502 kW (tarifa e lartë) dhe TU=052699 kW (tarifa e ulët).

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 03.04.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në procesverbalin e inspektimit nr. 1941641 e datës 27.03.2013 si dhe rrjedhës së energjisë elektrike.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 09.09.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të korrigjoj faturat 01130DPR-2004150, 02130DPR-2004150 dhe 03130DPR- 2004150 duke bërë shpërndarjen e kW të regjistruar në tarifën e lartë për periudhat janar, shkurt dhe mars 2013 sipas proporcionit në vijim: periudha janar 2013 me TL=33% dhe TU=67%; shkurt 2013 me TL=31% dhe TL=69%; dhe periudha mars 2013 me TL=36% dhe TU=64%.



Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 27.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se sipas analizës së rrjedhës së energjisë vërehet se konsumatori ka pasur lexim të rregullt por që në disa raste nuk i ka funksionuar ndërruesi tarifor që bënë të dyshohet se konsumatori manipulon me vet ndërruesin tarifor.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pas arritjes së faturave të muajit janar dhe shkurt 2013 dhe ankesës së konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 27.03.2013 kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë inspektimin e pikës matëse dhe se kanë bërë edhe regjistrimin e gjendjes reale në njehsorin elektrik nr. 4939399 dhe se sipas procesverbalit gjendja e njehsorit elektrik ka qenë TL=028502 kW dhe TU= 052699 kW.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se sipas analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike konsumatori ka lexim të rregullt dhe se në disa raste të caktuara nuk i ka funksionuar ndërruesi tarifor duhet theksuar se sipas rrjedhës së energjisë elektrike se konsumatori gjatë tërë periudhës së faturimit është faturuar bazuar në shpenzimet e regjistruar në dy tarifatat përveç periudhave janar, shkurt dhe mars 2013 kur konsumatorit i janë dërguar faturat vetëm për shpenzimet e regjistruara në tarifën e lartë dhe me zero shpenzime në tarifën e ulët, duke përsëritur pra gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në periudhën dhjetor 2012 në tarifën e ulët, dhe se ky shpenzim i faturuar vetëm në tarifën e lartë ka vazhduar edhe në muajt qershor, korrik dhe gusht 2013. Po ashtu sipas listave të leximit, shpenzimi i konsumatorit në tarifën e ulët për periudhat janar, shkurt dhe mars 2013 mbetet i pa ndryshueshëm përkatësisht në periudhën janar kemi 52700 kW, ndërsa në periudhat shkurt dhe mars 2013 është 52699 kW e që vërteton që njehsori elektrik i konsumatorit nuk bënë matjen e energjisë elektrike të shpenzuar në tarifën e ulët. Sipas kësaj vërehet se ndërruesi tarifor nuk ka funksionuar në muajt janar, shkurt dhe mars 2013, dhe në muajt qershor, korrik dhe gusht 2013, ndërsa në muajt prill dhe maj është evidentuar se ka punuar ndërruesi tarifor. Sipas kësaj Bordi i ZRRE-së thekson se në momentin e verifikimit të gjendjes së njehsorit elektrik, me të cilën është konstatuar se nuk punon ndërruesi tarifor dhe i cili është vërejtur nga lexuesi çdo muaj, punëtorët e KEK-ut është dashur ta rregullojnë ndërruesin tarifor ashtu që të mos lejojnë që njehsori dy tarifor të regjistrojë energji vetëm në njërin tarifë ose të bëjnë ndërrimin e njehsorit elektrik te konsumatori.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar faturat e energjisë elektrike e periudhës janar, shkurt dhe mars 2013 dhe konstaton se konsumatori është faturuar bazuar në shpenzimet reale të krijuara në një tarifë të vetme, por që duke pasur parasysh shpenzimet e me hershme të konsumatorit si dhe mos funksionimin e ndërruesit tarifor KKDFE duhet të bëjë korrigjimin e faturave të energjisë elektrike të periudhës së lartcekur ashtu që shpenzimi i regjistruar në muajt janar, shkurt dhe mars 2013 të llogaritet me proporcionin e shpenzimeve të regjistruara në periudhat janar, shkurt dhe mars 2012.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1019\_09\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar